

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË AKORDIMIT TË FONDEVE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE, PËR MARRJEN E MASAVE PARANDALUESE DHE REHABILITUESE NDAJ FATKEQËSIVE, NË INFRASTRUKTURËN E DËMTUAR, SI DHE VEPRIMTARIVE TË TJERA NË FUSHËN E MBROJTJES CIVILE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektvendim ka si qëllim përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përdorimit të fondeve të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive natyrore, për mbulimin financiar të veprimtarive të tjera të AKMC-së në fushën e mbrojtjes civile.

Projektvendimi del në zbatim të shkronjës “d”, pika 6, e nenit 23, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, ku përcaktohet se “Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile planifikon fonde për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si dhe veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile, kriteret dhe procedurat e akordimit të të cilave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi ka karakter teknik dhe nuk lidhet me programin politik të Këshillit të Ministrave dhe as me dokumente të tjera politike.

Projektvendimi është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2022.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” përcakton detyrimet e organeve të qeverisjes qendrore dhe të organeve të qeverisjes vendore, si pjesë e sistemit të mbrojtjes civile, për marrjen e masave dhe funksionimit në tërësi të aktiviteteve që synojnë mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit nga dëmtimi ose rreziku i dëmtimit, si pasojë e fatkeqësive natyrore apo fatkeqësive të tjera.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të akordimit të fondeve të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si dhe veprimtarive të tjera në fushën e mbrojtjes civile”.

dhe institucionet qendrore dhe për institucionet e qeverisjes vendore, ngarkon edhe AKMC-në për marrjen e masave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet ndërhyrjeve me mjete financiare për zvogëlimin e riskut ndaj një fatkeqësie, rehabilitimin dhe mbrojtjen civile.

Ndërhyrja e AKMC-së në rastet e fatkeqësisë apo për veprimtari të mbrojtjes civile, mund të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo në raste të tjera, duke akorduar fonde njësisive të qeverisjes vendore, për rastet kur këto të fundit nuk kanë fonde të mjaftueshme për të ndërhyrë dhe kur nga fatkeqësia rrezikohet jeta e njerëzve, pronës, mjedisit etj.

Projektvendimi synon të unifikojë procedurat dhe kriteret e përdorimit të fondeve të AKMC-së, për përmbushjen e misionit të saj për mbrojtjen civile.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim është në harmoni të plotë me rendin e brendshëm juridik dhe atë ndërkombëtar. Projektvendimi propozohet në bazë të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “d”, pika 6, e nenit 23, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS* TË BE

Projektvendimi nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi del në zbatim të shkronjës “d”, pika 6, e nenit 23, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” dhe përbëhet nga 14 pika.

Sipas pikës së parë të projektvendimit, AKMC-ja i planifikon fondet në buxhetin vjetor të saj, për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese e mbrojtëse, për përgjigjen ndaj fatkeqësive, rehabilitimin e dëmeve të ndodhura nga një fatkeqësi apo në funksion të veprimtarive të tjera, brenda sferës së mbrojtjes civile.

Sipas pikës së dytë, procesi i akordimit të fondit për AKMC-në dhe përdorimi i tij bazohet në disa dokumente politike e strategjike në fushën e mbrojtjes, siç janë: strategjia kombëtare e zvogëlimit të riskut në nivel qendror dhe vendor, vlerësimi i riskut në nivel qendror dhe vendor, si dhe planin kombëtar të emergjencave civile në nivel qendror dhe vendor.

Në pikën tre të projektvendimit përcaktohet se këto fonde mund të përdoren nga vetë AKMC-ja ose mund të transferohen te bashkia.

Sipas pikës katër, fondet përdoren nga vetë AKMC, në dy raste:

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të akordimit të fondeve të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si dhe veprimtarive të tjera në fushën e mbrojtjes civile”.

menaxhimin e riskut të mbetur.

Së dyti, në rastet kur pasojat e fatkeqësisë shtrihen në territorin e juridiksionit të disa njësive të vetëqeverisjes qendrore të më shumë se një qarku, ose pavarësisht shtrirjes territoriale të fatkeqësisë, kur shkalla e dëmit është e lartë në jetë njerëzish apo në pronë.

Pika pesë përcakton kushtet që duhet të plotësohen në mënyrë që fondet t'i transferohen njësisë së vetëqeverisjes vendore, në territorin e së cilës ka ndodhur fatkeqësia, të cilat janë: së pari, duhet të lindë nevoja për kryerjen e shpenzimeve shtesë për përballimin e situatave të krijuara nga fatkeqësitë; së dyti, kostoja e kësaj ndërhyrjeje tejkalon buxhetin vjetor të dedikuar për mbrojtjen civile të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Në pikat gjashtë, shtatë dhe tetë të projektvendimit përcaktohet procedura dhe afatet që ndiqen nga njësitet e vetëqeverisjes vendore, prefekti i qarkut, si dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile që prej nisjes së procesit me paraqitjen e kërkesës, afatet për paraqitjen e kërkesës dhe për plotësimin e saj, paraqitja e argumenteve për pranimin apo refuzimin.

Pika nëntë përcakton AKMC-në si institucion përgjegjës për hartimin dhe miratimin e urdhrave për akordimin e fondit për mbrojtjen civile, planifikuar në buxhetin vjetor të saj.

Në pikën dhjetë përcaktohet se fondet financiare të krijuara në AKMC, nga donacione të subjekteve dhe individëve të ndryshëm, për përballimin e situatave të krijuara, si pasojë e një fatkeqësie, të administrohen nga njësitet e qeverisjes vendore, sipas destinacionit të përcaktuar në urdhrin e nxjerrë nga AKMC-ja, për këtë qëllim.

Pika njëmbëdhjetë përcakton që prefekti i qarkut siguron dhe kontrollon zbatimin e urdhrin nga njësitet e qeverisjes vendore, si dhe mënyrën e përdorimit të tij, sipas destinacionit të përcaktuar.

Pikat dymbëdhjetë përcakton kompetencat e AKMC-së për inspektim mbi fondet e akorduara.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi do të ngarkohen institucionet dhe strukturat qendrore dhe vendore të mbrojtjes civile.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të akordimit të fondeve të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si dhe veprimtarive të tjera në fushën e mbrojtjes civile".

...me derguar për mendim pranë Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë,
Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Drejtësisë.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë është shprehur dakord.

Ministria e Brendshme është shprehur me sugjerime, të cilat janë pranuar dhe janë reflektuar
në përmbajtjen e projektvendimit.

Ministria e Drejtësisë është shprehur me sugjerime, një pjesë e të cilave janë pranuar dhe për
pjesën tjetër janë përgatitur argumentet përkatëse.

Projektvendimi do të dërgohet për mendim edhe pranë Këshillit Konsultativ të Qeverisjes
Qendrore dhe Vetëqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet financiare të këtij projektvendimi do të mbulohen nga buxheti i shtetit, akorduar
AKMC-së për mbrojtjen civile.

MINISTRI I MBROJTJES

Niko Peleshi



Relacion shpjegues për projektvendimin "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të akordimit të fondeve të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si dhe veprimtarive të tjera në fushën e mbrojtjes civile".